



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit!

1

protestuesit

2

LIVE TV: Qytetarët sërish në protestë, mbledhen te Kryeministria. Lironi

3

Jeni suflaçë, 'turp', protestuesit kalojnë në mes të 'Fan Zone'! Thirrje qytetarëve t'i bashkohen tubimit (VIDEO)

4

Dritan Goxhaj u lexon deklaratën protestuese: Urimë SHBA-ve Ditën e Pavarësisë, u kanë qëndruar pranë popullit shqiptar!

5

Flamingot kanë mbetur simbol i protestave

6

Zvërneci, Rama për median gjermane ZDFheute: S'mund t'u them jo 4 miliardë!

7

Je një Peshorë? Ja çfarë karakteristikash ke dhe si ndikon Hëna dhe Eklipsi Diellor në shenjen tuaj

Kronikë

U zhvati 50 mln € evropianëve me Call Center, arrestohet bos i rrjetit Granit Pepnika! VIDEO kur kapet në vilën luksoze në Dhërmi, pranga edhe bashkëpunëtorëve


Granit Pepnika, i akuzuar si bos i një rrjeti mashtrimi përmes Call Center, është arrestuar në një resort në Dhërmi. Grupi i Pepnikës që zhvati 50 mln € nga evropianët përmes Call Center-ave u godit në prill të këtij viti. Gjykata e Tiranës kishte caktuar masën e arrestit në burg për mashtrim kompiuterik dhe pastrim parash. Në pranga edhe dy bashkëpunëtorë të tij.

■ Policia rrethon vilën luksoze në Dhërmi, momenti kur arrestohet bossi i Call Center, Granit Pepnikaj (VIDEO)

REPORT TV Policia rrethon vilën luksoze në Dhërmi, momenti kur arrestohet bossi Report TV




Redaksia 3 Korrik, 14:55 | Përditësimi: 3 Korrik, 22:40



VLORE- I shpallur në kërkim ndërkombëtar që prej muajit maj, merr fund arratia e **bossit të mashtrimeve me call center**, Granit Pepnikaj.

29-vjeçari që u kap nga policia e Vlorës dhe Forcat Operacionale teksa po qëndronte në një vilë luksoze në **Dhërmi**. Në pranga përfundoi edhe bashkëpunëtori i tij, 31-vjeçari **Xhoni Hitaj**, edhe ai i shpallur në kërkim.

Të dy u kapën në flagrancë pasi policia kishte rrethuar resortin, ndërsa mësohet se ata nuk bënë rezistencë.



LEXO EDHE: **Dominojnë të rinjtë, qindra turistë nga Korfuzi në Sarandë: Deti i pastër dhe njerëz mikpritës! Rezervimet vijnë dhe për gushtin**

Gjatë këtij operacioni, për përkrahje të autorit të kimit, policia arrestoi edhe 28-vjeçarin nga Tirana, **Redion Rexhmati**.

Gjatë kontrolleve të ushtruara në vilën në Dhërmi, ku ata po pushonin u gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pistoletë dhe një sasi lënde narkotike të dyshuar Cannabis sativa.

Ndaj Pepnikajt dhe Hitajt, Gjykata e Tiranës kishte caktuar masën e arrestit në burg për veprën penale të mashtrimit kompiuterik.

Arrestimi i 29-vjeçarit Pepnikaj shënon një zhvillim të rëndësishëm në një prej dosjeve më të mëdha të mashtrimit ndërkombëtar me **call center**.

Sipas hetimeve, dyshohet se ai organizonte rrjetin e call center-ave që mashtronte qytetarët e vendeve të Bashkimit Europian, duke i bindur të investonin në platforma të bursës. Dëmi ekonomik vlerësohet mbi 50 milionë euro.

Nga hetimet rezulton se Pepnikaj zotëronte 50% të aksioneve të shoqërisë "Gama Media Communication", themeluar në korrik 2021 me Jurgen Melën.

Operacioni për goditjen 3 e call center-ave mashtrues që ushtronin aktivitetin kriminal në 12 zyra në kryeqytet, u krye në prill të këtij viti pas një hetimi dyvjeçar të Prokurorisë së Tiranës në bashkëpunim me autoritetet austriake. Gjatë këtij aksioni, u sekuestruan 900 mijë euro cash dhe në pranga ranë 10 persona.

Kur u godit rrjeti i Call Center-ave mashtrues?

Operacioni për goditjen 3 e call center-ave mashtrues u krye në prill të këtij viti pas një hetimi dy vjeçar me të Prokurorisë së Tiranës në bashkëpunim me autoritetet austriake. Gjatë këtij aksioni, u sekuestruan 900 mijë euro cash dhe në pranga ranë 10 persona.

Qëllimi i mashtruesve në këto 3 call center, ishte të piketonin qytetarë evropianë të cilët i kishin humbur paratë në skema të tilla. Operatorët premonin se mund t'i rikuperonin paratë që ata kishin humbur. Veçse për ta bërë këtë, do duheshin pagesa, nga 1 mijë euro. Pra skema fillonte me 1 mijë euro për të rikuperuar 10 mijë euro të humbura, përsëhembull, por gjatë procesit mashtruesit kërkonin edhe shuma të tjera parash. Qëllimi: T'i merrnin personave të mashtruar një herë, edhe qindarkat e fundit që u kanë mbetur.


.....

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 17:04
Policia rrethon vilën luksoze në Dhërmi, momenti kur arrestohet bossi i Call Center, Granit Pepnikaj (VIDEO)

REPORT TV Policia rrethon vilën luksoze në Dhërmi, momen Report TV



Granit Pepnikaj, i shpallur në kërkim ndërkombëtar u arrestua sot në një resort në Dhërmi. Në këto pamje mund të shihet momenti i operacionit nga Policia e Vlorës dhe Forca Operacionale, të cilat rrethojnë një vilë luksoze në Dhërmi në të cilën ndodhej Pepnikaj, i cili sipas burimeve nuk bëri rezistencë.

Pepnikaj kërkoej që prej majit 2026, pasi Gjykata e Tiranës i caktoi masën "arrest me burg" për **mashtrim** kompiuterik dhe pastrim parash.

Gjatë kontrollit të ushtruar në vilën ku qëndronin, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pistoletë, si dhe një sasi lënde narkotike, e dyshuar cannabis sativa.

SL.E./Shqiptarja.com

Xh.K/P.J/Shqiptarja.com

TAG: **mashtrim** **Call center** **Dhermi** **Vlore** **Granit Pepnika** **redion rexhmati** **xhoni hitaj**

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: Sipas jush, protesta te Kuvendi a ka qenë e dhunshme nga ana e protestuesve? 3 Korrik, 10:41

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju P





Lajmi i fundit



Dritan Goxhaj u lexon deklaratën protestuesve: Urime SHBA-ve Ditën e Pavarësisë, u kanë qëndruar pranë popullit shqiptar!

4 Korrik, 19:26



RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

